



Kompania Rajonale e Ujësjesit Gjakova, Sh.A , duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/ 2024 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, dhe Rregulloren e Brendshme Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin publik- KRU-Gjakova shpall :

## K O N K U R S T Ë J A S H T E M

**Titulli i vendit të punës-** *Lexues / Shpërndarës i Faturave*

**Titulli i Mbikëqyrësit :** Shefit të Sesionit Komercial , Menaxherit Komercial

**Numri i Referencës :** 3061

**Numri i pozitave:** 1 ( Një )

**Vendi i Punës:** Rahovec

**Paga-** 600 €

**Kohëzgjatja e kontratës :** Në Kohë të caktuar, ndërsa Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës /Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

**Orari i punës-** I Plotë

**Procedura e Aplikimit :** I jashtëm

### **Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :**

- Ngarkohen me faktura për çdo muaj veç e veç gjatë vitit, që bëhen për ujin e pijes të shpenzuar sipas klientëve –konsumatorëve që kanë në evidencën –regjistrin e tyre
- Sipas evidencës –regjistrin të tyre bëjnë shpërndarjen e faturave të klientit - konsumatorët sipas evidences në lokacionin e tyre ,
- Njoftojnë klientët –konsumatorët që për borgjet e pa paguara e të mbetura me saldo mund të bëjnë riprogramimin e tyre në afat 1-36 muaj /kiste ,duke arritur marrëveshje dhe duke nënshkruar ato ku thuhet se së bashku me faturen e muajit të fundit duhet paguar edhe kësti mujor i borxhit .
- Për çdo mosrespektim të marrëveshjes së riprogramimit të borgjit nga ana e klientit –konsumatorit që në herën e pare të cilit do muaj për pagesen e borgjit ,bëhet kërkesa për çkyçje ,duke kërkuar ekipin e çkyçjes për të çkyçur klientin –konsumatorin ,ku menagjeri i shërbimit cakton datën ,oren dhe siguron pjesmarrjen e policisë ;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdherit të shefit ,Menaxherit të Shitjes
- Regjistron për çdo muaj gjendjen e sakt të ujit të pijes të shpenzuar perms ujëmatësit te klientët –konsumatorët dhe ate 100% ,sipas evidences që ka në lokacionin e tij, duke evidentuar në librin regjistrin e tij .
- Regjistron për çdo muaj gjendjen e sakt të klientëve –konsumatorëve që shpenzojnë ujin e pijes pa ujëmatës (paushall ),bëjnë evidentimin e tyre në lokacionin e tij duke bërë procesverbalin me të gjitha të dhënat ,si dhe raportojnë në Kompani
- Gjatë leximit obligohen të evidentojnë perms procesverbalit – rastet; e zbulimit të ujmatësve në gjendje jo të rregullt ,rastet e kyçjeve të pa ligjshme–ilegale (së paku 2 lidhje), si dhe rastet e konsumatorëve të ri dhe i raportojnë ato në menyrë të rregullt çdo ditë duke mbajt edhe evidencat në librin e tyre ,duke paraqit te menaxheri i shërbimit të shitjes ,i cili vazhdon procedurat për masat konkrete ligjore .
- Lajmëron prishjet dhe rrjedhjet e ujit të pijes që ndodhin në terrenin e tij
- Përgjigjet shefit të tij përkatësisht menaxherit ekzekutiv ;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (mëturje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi.

### **Kualifikimi, përvoja e punës/Aftësi të tjera**

- Përgatitja profesionale/Shkollore – Shkolla e Mesme
- Së paku 1 vjet përvojë pune
- Njohja e punës me kompjuter: njohuri për kompjuter (MS. Office)

### **Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjese e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre – Formati PDF**

Gjatë aplikimit për pozitën në fjalë kandidatët duhet të kenë kujdes hapat e aplikimit:

- Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës elektronike (email) [burimet.njerezore@kru-gjakova.com](mailto:burimet.njerezore@kru-gjakova.com).
- Në email për aplikim duhet të bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
  - Aplikacioni ( formulari) për konkurrim shkarkohet në ueb-faqen e Kompanisë [www.kru-gjakova.com/aplikacion-per-punesim/](http://www.kru-gjakova.com/aplikacion-per-punesim/)
  - CV-ja
  - Dëshmia e kualifikimit – Kopjen e Diplomës së Shkollës së Mesme-noterizuar, nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin për nostrifikim të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedure të nostrifikimit , me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e përfundimit të procedurave të rekrutimit/përzgjedhjes për atë pozitë.
  - Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime jo më e vjetër se 6 muaj.
  - Kopjet e dëshmisë së punësimit/përvojës së punës.
  - Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës
  - Kopja e Certifikatës së lindjes,

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje/të skanuara me pdf

### **Dëshmitë që nuk kërkohen gjate aplikimit por kërkohen në fund të procesit përpara nënshkrimit të kontratës së kandidatit/es së përzgjedhur:**

- Aplikantët mbajnë përgjegjësi për origjinalitetin e dokumentacioneve të dorëzuar përmes e-mailit ,dhe origjinalet apo të njësuara me origjinalet- mund të kërkohen përpara nënshkrimit të kontratës.
- Certifikata shëndetësore

### **Mënyra e aplikimit**

Aplikimi behet përmes e-mailit elektronik [burimet.njerezore@kru-gjakova.com](mailto:burimet.njerezore@kru-gjakova.com) , **ku bashkëngjiten të gjitha dokumentet sipas kërkesave në konkurs.** \_Aplikacionin për punësim e shkarkoni në: [www.kru-gjakova.com/aplikacion-per-punesim/](http://www.kru-gjakova.com/aplikacion-per-punesim/). Të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit duhet të dërgohen në email, pas aplikimit të suksesshëm **do të pranoni një e-mail për konfirmim, nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues,** atëherë kontaktoni në nr. E tel. 0390 310513, gjithashtu mund të shkruani edhe në e-mailin e mësipërm për të vërtetuar aplikimin tuaj **vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues.**

### **Njoftimi me rezultatet e konkursit publik**

Lista e kandidateve te cilët i plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet në tabelën e shpalljeve të kompanisë të KRU Gjakova Sh.a, gjithashtu kandidatet individualisht do të njoftohen për rezultatin e këtij konkursi duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

### **Mënyra e Vlerësimit të kandidateve**

- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) Pikë
- Intervista deri në njëzet (20) pike
- Jetepërshkrimi ( CV) deri në dhjetë (10) pike

### **Kalendari i përafërt i procedurave të rekrutimit -**

- Brenda 7 ditëve pas mbylljes së konkursit- Njësia e BNJ bën verifikimin paraprak të aplikacioneve (**Listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet**)
- Testimi me shkrim zhvillohet brenda 10 ditëve pas përfundimit të fazës së verifikimit paraprak të aplikacioneve
- Kandidatët e suksesshëm ftohen në interviste brenda 7 ditëve nga data e mbylljes së vlerësimit të testit me shkrim.
- Pas përfundimit të intervistave Njësia e BNJ brenda 5 ditëve harton raportin përfundimtar ku bën kalkulimin e pikëseve në çdo faze dhe bën shpalljen rezultateve përfundimtare vetëm për kandidatet fitues, me më së shumti pikë të fituara dhe njofton kandidatët në mënyrë individuale përmes e-mailit elektronik.
- Ankesat që mund të paraqiten gjatë procesit të rekrutimit do të pezullojnë afatet e lartcekura konform UA01/2024

**KRU Gjakova Sh.a fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për pozitën/at e publikuar/a**

**Afati i konkurrimit është nga data 13/11/2024 deri me 27/11/2024. deri në ora 16:00h.**

**Vërejtje:** Aplikacionet pranohen vetëm përmes e-mailit elektronik, ato të dërguara pas afatit për aplikim dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.